

Atlantik Sh.a.

Pasqyrat Financiare për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013

Përmbajtja:


Raporti i Audituesit të Pavarur	3
Pasqyra e Pozicionit Financiar	5
Pasqyra e të Ardhurave Gjithëpërfshirëse	6
Pasqyra e Ndryshimeve në Kapital	7
Pasqyra e Flukseve të Mjeteve Monetare	8
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare	9 - 42

(Opinioni)

Atlantik sh.a.**Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2013***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)*

		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Aktivët			
Pasuri dhe Pajisje	4	29,819,950	37,560,119
Investim ne pasuri te paluajjtshme	5	445,497,508	468,944,747
Kosto te shtyra te marrjes ne sigurim		76,772,502	68,118,805
Aktive te Patrupezuara	7	2,568,994	2,635,470
Depozita me afat ne banka	8	494,113,496	499,204,229
Aktive risigurimi	9	13,477,033	92,574,170
Llogari te arketueshme sigurimi dhe te tjera	10	167,198,033	241,232,550
Cash dhe ekuivalente te tij	11	7,012,054	16,767,009
Totali Aktiveve		1,236,459,570	1,427,037,100
Detyrimet			
		-	-
Rezerva teknike te sigurimit	12	393,688,544	510,443,717
Detyrime ne risigurim	14	21,345,097	34,864,822
Rezerva per Fondin e Kompesimit		19,682,087	
Llogari te pagueshme sigurimi dhe te tjera	15	156,707,876	171,130,870
Te pagueshme aksionevere		98,378,000	-
Detyrime tatime per tu		-	23,318,495
Total Detyrimet		689,801,603	739,757,904
Kapitali Aksioner			
Kapitali I Nenshkruar		657,730,491	628,336,081
Rezerva te pergjithshme		16,891,912	-
Fitime /Humbje te mbartura		33,783,824	0
Fitimi/Humbja e vitit		(161,748,260)	58,943,115
Rezerva e Katastrofes		-	-
Totali I Kapitalit Aksioner		546,657,967	687,279,196
Total Detyrimet dhe Kapitali Aksioner		1,236,459,570	1,427,037,100

Dritan Çelaj
Drejtor i përgjithshëm




Juliana Bëto
Drejtorja e Financës



Atlantik sh.a.**Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2013***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)*

		31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Prime te shkruara	16	385,230,776	666,520,130
Ndryshimi ne rezerven e primit te pafituar		50,187,452	(1,629,112)
Te ardhurat bruto nga primet e sigurimit		435,418,228	664,891,018
		-	-
Prime te çeduar ne risigurim		(34,160,822)	(38,815,105)
Ndryshimi ne rezerven e primit te pafituar, pjesa e risiguruesit		(719,706)	(1,523,933)
Primet e fituara neto	16	400,537,701	624,551,980
		-	-
Te ardhura nga komisione e te tjera		5,009,653	2,948,532
E ardhura Neto		405,547,354	627,500,512
		-	-
Deme te Ndodhura		(171,100,952)	(27,029,636)
Deme te paguara nga Risiguruesit		(65,866,531)	(40,520,778)
Ndryshimi ne rezerven e primit te paskaduar		-	-
Deme neto te paguara	17	(236,967,483)	(67,550,414)
		-	-
Ndryshimi ne rezervat e tjera teknike		-	-
Kosto te Marrjes ne Sigurim		(137,297,883)	(189,499,948)
Ndryshim ne kosto te shtyra te marrjes ne sigurim		404,697	(5,222,634)
Shpenzime te tjera Operative	18	(203,385,882)	(304,022,890)
Shpenzime te tjera te sigurimit		(6,353,296)	(16,490,457)
Fitimi Operativ		(178,052,493)	44,714,169
		-	-
E ardhura nga Interesat		20,452,724	19,070,681
Te ardhura nga shkembimet valutore		(3,085,174)	4,138,575
Te ardhura nga shkembimet valutore		5,074,890	4,138,575
Humbje nga shkembimet valutore		(6,138,207)	(4,113,958)
Te ardhurat neto		16,304,232	19,095,298


Atlantik sh.a.**Pasqyra e pozicionit financiar me 31 dhjetor 2013**

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

	-	-
Fitimi para tatimit	(161,748,260)	63,809,467
Taksa te shtyra	-	-
Tatimi mbi fitimin	-	(13,133,731)
	-	-
Fitimi Neto	(161,748,260)	50,675,736
		0

Shënimet shoqëruese 1 deri në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Dritan Çelaj
Drejtore i përgjithshëm



Juliana Billo
Drejtore e Financës



Atlantik sh.a.**Pasqyra e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2013***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)*

	Kapitali I nenshkuar	Rezerva te Pergjithshme	Rezerva Katastrofe	Fitime te Akumuluara	Total
Saldo me 31 Dhjetor 2011	<u>566,403,669</u>	<u>13,518,104</u>	<u>-</u>	<u>48,414,307</u>	<u>628,336,080</u>
Kapitali I Nenshkuar	-	-	-	-	-
Fitime te Akumuluara	13,518,104	(13,518,104)	-	-	-
Rezerva e katastrtofes	48,414,307	-	-	(48,414,307)	-
Fitimi/Humbja e Vitit	-	-	-	50,675,736	50,675,736
Saldo me 31 Dhjetor 2012	<u>628,336,080</u>	<u>-</u>	<u>-</u>	<u>50,675,736</u>	<u>679,011,816</u>
Kapitali I Nenshkuar	29,394,411	-	-	-	29,394,411
Fitime te Akumuluara	-	-	-	-	-
Rezerva e katastrtofes	-	16,891,912	-	(16,891,912)	-
Fitimi/Humbja e Vitit	-	-	-	-	-
Saldo me 31 Dhjetor 2013	<u>657,730,491</u>	<u>16,891,912</u>	<u>-</u>	<u>33,783,824</u>	<u>708,406,227</u>

Shënimet shoqëruese 1 deri në 27 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Atlantik sh.a.**Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)*

Flukset monetare nga aktivitetet operative	31 Dhjetor 2012	31 Dhjetor 2013
Fitimi i Vitit	72,076,846	(161,748,260)
Rregullime për të rakorduar fitimin neto me flukset monetare neto nga aktivitetet operative		
Zhvleresimi dhe amortizimi	27,836,995	32,557,158
Ndryshimi ne rezervat teknike	(13,155,380)	(116,755,174)
Te ardhura nga shitja e pasuurive dhe pajisjeve		
Ndryshimi ne rezervat e risigurimit	29,533,811	66,586,237
Tatimi I parapaguar	13,133,731	-
Te ardhura nga interesat	(19,070,681)	(20,452,724)
Fitimi operativ përpara ndryshimeve në kapitalin qarkullues	110,355,321	(199,812,762)
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:		
Ulja/(Rritja) llogari te arketueshme te sigurimit dhe te tjera	(24,760,284)	74,034,517
Ulja/(Rritja) tatimit mb fitimin te parapaguar		
Ulja/(Rritja) ne shpenzimet e marrjes ne sigurim te shtyra	13,471,634	(404,697)
Ulja/(Rritja) ne detyrimet ne risigurim	5,650,424	(13,519,725)
Ulja/(Rritja) ne detyrimet e tjera	48,232,173	(26,801,624)
Ulja/(Rritja) ne diferencat e konvertimit		
Ulja/(Rritja) llogari te pagueshme pronarit	(15,150,847)	(18,936,301)
Interesa te arketuara	126,609,472	(170,495,249)
<i>Cash flow I gjeneruar nga aktiviteti operues</i>	-	-
<i>Cash flow nga aktiviteti investues</i>	(150,244,455)	31,187,408
Blerja e makinerive dhe pajisjeve	-	-
Shitje pasurie e paluajtshme	1,247,485	(66,476)
Rritje ne aktivet e patrupezuara	30,657,017	5,090,734
Rritja ne depozita me afat ne banka	(118,339,954)	36,211,666
<i>Cash flows nga aktiviteti financues</i>	-	-
Ndarje e dividendit	-	-
Zmadhim Kapitali	-	-
<i>Cash flows nga aktiviteti financues</i>	8,269,518	(134,283,583)
Ulja/(Rritja) Neto ne Cash dhe ekuivalente te tij	8,497,491	16,767,009
Paraja dhe ekuivalente te tij ne fillim te vitit	16,767,009	7,012,054

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

1 Informacione të përgjithshme

Atlantik Sh.a. ("Shoqëria") është një shoqëri aksionare shqiptare me qendër në Tiranë, e cila ofron shërbime sigurimi për mjetet motorike, pasurinë, shëndetin, mjetet lundruese dhe shërbime të tjera sigurimi.

Shoqëria është regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendim të Gjykatës së Tiranës nr. 25720, datë 2 maj 2001, në përputhje me Ligjin nr. 8081, datë 7 mars 1996, "Mbi aktivitetin e sigurimit dhe të risigurimit" dhe është subjekt i Ligjit nr. 9267 "Mbi aktivitetin e sigurimit dhe të risigurimit dhe ndërmjetësimet në sigurime dhe risigurime" datë 29 korrik 2004 ("Ligji i sigurimeve").

Në 31 dhjetor 2013 dhe 2012 shoqëria operon me seli qendrore në Rr. "Themistokli Germezi", 3/1, Tiranë, Shqipëri dhe me 13 dege në Tiranë, Dibër, Berat, Durrës, Elbasan, Fier, Gjirokastrë, Korçë, Kukës, Lezhë, Lushnjë, Shkodër, dhe Vlorë.

Më 31 dhjetor 2013 shoqëria ka 99 punonjës (2012: 131).

2 Politikat kontabël

Politikat kontabël kryesore të përdorura në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare janë detajuar si më poshtë. Këto politika janë aplikuar në mënyrë të qëndrueshme në të gjitha vitet e paraqitura, përveç nëse përcaktohet ndryshe.

2.5 Baza përgatitjes dhe baza e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("SNRF") publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit ("BSNK") dhe interpretimet e publikuara nga Komisioni i Interpretimeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar ("KINRF") të BSNK. Pasqyrat financiare janë përgatitur duke përdorur bazat e vlerësimit të specifikuar nga SNRF për çdo klasë të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Bazat e vlerësimit janë përshkruar në mënyrë më të qartë në politikat kontabël të paraqitura si më poshtë.

Përgatitja e pasqyrave financiare në pajtueshmëri me SNRF kërkon përdorimin e disa vlerësimeve kritike të caktuara të kontabilitetit. Ato kërkojnë gjithashtu nga drejtimi që të ushtrojë gjykimin e tij në procesin e aplikimit të politikave të kontabilitetit të Shoqërisë. Pjesët që përfshijnë një shkallë më të lartë të gjykimit ose zonat komplekse, apo zonat ku supozimet dhe vlerësimet janë të rëndësishme për pasqyrat financiare janë pasqyruar në shënimin 3: "Gjykimet kritike të kontabilitetit dhe burimet kryesore të vlerësimit të pasigurisë".

Pasqyrat financiare janë paraqitur në monedhën Shqiptare Lekë, rrumbullakosur në mijëshen më të afërt përveç kur është cilësuar ndryshe.

2.6 Zbatimi i standardeve të reja dhe të përditësuara

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

(a) Zbatimi i ‘Paraqitja e zërave të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse’ (Ndryshimet në SNK 1)

Shoqëria ka zbatuar ndryshimet e SNK 1 ‘Paraqitja e Zërave të Ardhurave të Tjera Gjithëpërfshirëse’. Ndryshimet në SNK 1 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 korrik 2012 ose më pas dhe u kërkon shoqërive të grupojnë zërat e paraqitur në pasqyrën e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse në përputhje me SNRF-t e tjera, në zëra të cilët nuk do të riklasifikohen në vijimësi në fitim ose humbje dhe në zëra që do të klasifikohen në vijimësi në fitim ose humbje kur kushtet specifike të jenë plotësuar. Mundësia aktuale për të paraqitur zërat e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse para tatimit ose pas tatimit mbetet e pandryshuar; megjithatë, në qoftë se zërat janë paraqitur para tatimit, atëherë ndryshimet në SNK 1 kërkojnë të pasqyrohet veçmas tatimi që lidhet me secilin prej të dy grupeve të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse.

(b) Standardet, ndryshimet dhe interpretimet në lidhje me standardet ekzistuese që nuk janë ende efektive dhe që nuk janë adoptuar më përpara nga shoqëria.

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa standarde të reja, ndryshime dhe interpretime të standardeve ekzistuese janë publikuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit por nuk janë ende efektive dhe nuk kanë qenë të adoptuara më parë nga shoqëria (përveç ndryshimeve në SNK 1 paraqitur më lart në pikën 2.a)

Drejtimi i shoqërisë parashikon që të gjitha deklaratimet do të adoptohen në politikat kontabël të shoqërisë në momentin që këto deklarime do të behën efektive. Informacionet në lidhje me standardet e reja, ndryshimet dhe interpretimet që priten të jenë të rëndësishme për pasqyrat individuale financiare të shoqërisë parashtrihen si më poshtë. Disa standarde dhe interpretime të reja janë publikuar por nuk pritet që të kenë ndikim material në pasqyrat individuale financiare të shoqërisë.

SNRF 9 Instrumentet Financiarë (SNRF 9)

BSNK synon të zëvendësojë SNK 39 “Instrumentet Financiarë: Njohja dhe matja” (SNK 39) në tërësinë e tyre me SNRF 9. Deri tani janë publikuar seksionet në lidhje me njohjen, klasifikimin, matjen dhe çregjistrimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare. Këto seksione do të jenë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2015 ose më pas. Seksionet në lidhje me metodat e zhvlerësimit dhe me kontabilitetin mbrojtës janë në zhvillim e sipër.

Më tej, në nëntor 2011, BSNK-ja paraprakisht vendosi të marrë në konsideratë disa modifikime të kufizuara në SNRF 9 për modelin e klasifikimit të aktiveve financiare për të adresuar çështjet e aplikimit. Drejtimi i shoqërisë ka ende për të vlerësuar ndikimin e këtij standardi të ri në pasqyrat individuale financiare të shoqërisë. Megjithatë, drejtimi nuk do të implementojë SNRF 9 deri në momentin që të gjitha seksionet do të publikohen në mënyrë që të vlerësojë ndikimin e të gjitha ndryshimeve.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

4 Politikat kontabël (vazhdim)

4.2 Zbatimi i standardeve të reja dhe të përditësuara (vazhdim)

Standardet e Konsoliduara

Një paketë me standardet e reja të Konsoliduara është efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 ose më pas. Informacioni në lidhje me këto standarde të reja paraqitet si më poshtë. Drejtimi i shoqërisë nuk e ka përfunduar ende vlerësimin e ndikimit të këtyre standardeve të reja dhe të rishikuara në pasqyrat individuale financiare të shoqërisë.

SNRF 10 Pasqyrat Financiare të Konsoliduara (SNRF 10)

SNRF 10 zëvendëson SNK 27 “Pasqyrat Financiare Individuale dhe të Konsoliduara”(SNK 27) dhe KIP 12 “Konsolidimi – Njësitë Ekonomike për qëllime të veçanta”. SNRF 10 rishikon përkufizimin e kontrollit dhe jep udhëzime të reja të zgjeruara në lidhje me zbatimin e tij. Këto kërkesa të reja ndikojnë në përcaktimin se cila nga shoqëritë e investuara është filial dhe për këtë arsye ndryshon qëllimi i konsolidimit. Megjithatë, kërkesat dhe procedurat e konsolidimit, kontabiliteti për ndryshimet në interesat jo-kontrollues dhe kontabiliteti për humbjen e kontrollit mbi një filial mbeten të njëjta. Analiza e provigjonimit të drejtimit të shoqërisë është që SNRF 10 nuk do të ndryshojë klasifikimin (si filiale ose ndryshe) të ndonjë prej investimeve ekzistuese më 31 dhjetor 2012.

SNRF 11 Marrëveshjet e përbashkëta (SNRF11)

SNRF 11 zëvendëson SNK 31 “Interesat në Sipërmarrjet e Përbashkëta (SNK 31)”. Ky standard përafrokontabilitetin e investitorëve me të drejtat dhe detyrimet e tyre në lidhje me marrëveshjet e përbashkëta. Përveç kësaj, opsioni i SNK 31 për të përdorur konsolidimin proporcional në sipërmarrjet e përbashkëta është eliminuar. SNRF 11 tani kërkon përdorimin e metodës së kontabilitetit të kapitalit, e cila përdoret aktualisht për investimet në pjesëmarrje.

SNRF 12” Shënimet shpjeguese në lidhje me interesat në shoqëritë e tjera” (SNRF 12)

SNRF 12 integron dhe përputh kërkesat për shënimet shpjeguese në lidhje me lloje të ndryshme investimesh duke përfshirë shoqëritë e strukturuar të pakonsoliduara. Ky standard paraqet kërkesa të reja për shënimet shpjeguese në lidhje me rrezikun ndaj të cilit ekspozohet një shoqëri nga përfshirja në subjektet e strukturuar.

Udhëzime për ndryshimet në SNRF 10, 11, 12

Pas publikimit të standardeve të reja BSNK ka bërë disa ndryshime në dispozitat kalimtare në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12. Udhëzimi konfirmon se shoqëria, në rrethana të caktuara, nuk është e detyruar të zbatojë SNRF 10 në mënyrë retrospektive dhe sqaron kërkesat për të paraqitur të dhëna krahasuese të rregulluara. Udhëzimi gjithashtu bën ndryshime në SNRF 11 dhe SNRF 12 të cilat ofrojnë asistencë të ngjashme për paraqitjen ose rregullimin e informacionit krahasues për periudhat përpara periudhës që do të pasojë menjëherë.

Më tej siguron asistencë shtesë duke hequr kërkesën për të paraqitur të dhëna krahasuese për informacionet shpjeguese në lidhje me shoqëritë e strukturuar të pakonsoliduara për çdo periudhë para periudhës së parë vjetore në të cilën është aplikuar SNRF 12. Udhëzimi i ri është gjithashtu efektiv për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 dhe më pas.

Ndryshime të rëndësishme të SNK 27 dhe SNK 28 “Investimet në Pjesëmarrje dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta (SNK 28).

Tani SNK 27 merret vetëm me pasqyrat financiare individuale. SNK 28 ka si qëllim interpretimin e investimeve në sipërmarrjet e përbashkëta. Megjithatë, metoda e kontabilitetit të kapitalit sipas SNK 28 mbetet e pandryshuar.

5 Politikat kontabël (vazhdim)

Atlantik sh.a.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

5.2 Zbatimi i standardeve të reja dhe të përditësuara (vazhdim)

SNRF 13 Matja me vlerë të drejtë (SNRF 13)

SNRF 13 sqaron përkufizimin e vlerës së drejtë dhe jep udhëzime dhe informacione shpjeguese në lidhje me matjen e vlerës së drejtë. Ky standard nuk ndikon në faktin se cilët zëra kërkohen të maten me vlerë të drejtë. SNRF 13 zbatohet në mënyrë prospektive për periudhat vjetore që fillojnë më ose pas 1 janar 2013. Drejtimi është në procesin e rishikimit të metodave të vlerësimit në mënyrë që të jenë në përputhje me kërkesat e reja dhe nuk ka përfunduar ende vlerësimin e ndikimit që do kenë këto ndryshime në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Ndryshimet në SNK 19 Përfitimet e Punonjësve (SNK 19 Ndryshimet)

Ndryshimet e SNK 19 përfshijnë një numër të caktuar përmirësimesh të synuara të standardit. Ndryshimet kryesore lidhen me planin e përcaktuar të përfitimeve.

Ato janë:

- eliminimi i “metodës së korridorit” duke i kërkuar shoqërive të njohin të gjitha humbjet dhe fitimet që kanë rezultuar gjatë periudhës raportuese,
- ndryshimet në matjen dhe paraqitjen e disa komponentëve të caktuar në kostot e përfitimeve të caktuara
- kanë rritur kërkesat për shënime shpjeguese duke përfshirë informacion në lidhje me planin e përcaktuar të përfitimeve dhe me rrezikun ndaj të cilit ekspozohen subjektet që marrin pjesë në to.

Ndryshimet e SNK 19 janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 dhe pas kësaj date dhe do të zbatohen në mënyrë retrospektive.

Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (Ndryshime në SNK 32)

Ndryshimet në SNK 32 japin udhëzime aplikative për të adresuar mospërputhjet në zbatimin e kriterëve të SNK 32 për kompensimin e aktiveve dhe detyrimeve financiare në dy fushat e mëposhtme:

- Kuptimi i shprehjes “aktualisht ka një të drejtë ligjore të zbatueshme për kompensim ”
- Disa sisteme të shlyerjes bruto mund të konsiderohen ekuivalent me shlyerjet neto.

Ndryshimet janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2014 ose më pas dhe kërkohen të aplikohen në mënyrë retrospektive. Drejtimi nuk parashikon një ndikim material të këtyre ndryshimeve në pasqyrat individuale financiare të shoqërisë.

Shënime shpjeguese – Kompensimi i aktiveve dhe detyrimeve financiare (Ndryshimet në SNRF 7)

Dhënia e informacioneve shpjeguese cilësore dhe sasiore është shtuar në SNRF 7 'Instrumentet Financiar: Shënime Shpjeguese' (SNRF 7) që lidhen me shumat bruto dhe neto të instrumenteve të njohur financiare që janë:(a) kompensuar në pasqyrën e pozicionit financiar dhe (b) që janë subjekt i marrëveshjeve të kompensimit të detyrueshme dhe marrëveshjeve të ngjashme, edhe në qoftë se nuk janë kompensuar në pasqyrën individuale të pozicionit financiar. Ndryshimet janë efektive për periudhat raportuese vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 ose më pas dhe periudhat e ndërmjetme brenda këtyre periudhave vjetore. Dhënia e informacioneve shpjeguese të kërkuara duhet të jepen në mënyrë retrospektive. Drejtimi nuk parashikon një ndikim material në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2 Politikat kontabël (vazhdim)

2.2 Zbatimi i standardeve të reja dhe të përditësuara (vazhdim)

Përmirësimet vjetore 2009-2011 (përmirësimet vjetore)

Përmirësimet vjetore 2009-2011 (përmirësimet vjetore) kanë bërë disa ndryshime të vogla në një numër të SNRF-ve. Ndryshimet e rëndësishme për shoqërinë janë përmbledhur si më poshtë:

Sqarimi i kërkesave për çeljen e pasqyrës së pozicionit financiar:

- sqaron që data e përshtatshme e çeljes së pasqyrës së pozicionit financiar është fillimi i periudhës së mëparshme (shënimet përkatëse nuk janë më të nevojshme të paraqiten)
- adreson kërkesat për të dhënat krahasuese për çeljen e pasqyrës së pozicionit financiar, kur një njësi ekonomike ndryshon politikat kontabël ose bën riparimet ose riklasifikime retrospektive, në përputhje me SNK 8.

Sqarimi i kërkesave në lidhje me informacionin krahasues i dhënë përtej kërkesave minimale:

- qartëson që informacioni plotësues i pasqyrave financiare nuk është i nevojshëm të paraqitet në formën e një grupi të plotë në pasqyrat financiare për periudhat përtej kërkesave minimale,
- kërkon që çdo informacion shtesë i paraqitur duhet të jetë në përputhje me SNRF-të dhe kërkon që shoqëria të paraqesë informacion krahasues në shënimet përkatëse në lidhje me atë informacionin shtesë.

Efekti tatimor i shpërndarjes tek mbajtësit e instrumenteve të kapitalit:

- adreson mospërputhjen e perceptuar ndërmjet SNK 12 “Tatimi mbi Fitimin” (SNK12) dhe SNK 32 “Instrumentet Financiar: Paraqitja” (SNK32) në lidhje me njohjen e pasojave të tatimit fitimit që lidhet me shpërndarjen tek mbajtësit e instrumenteve të kapitalit dhe të kostos së transaksionit për një transaksion kapitali
- sqaron se qëllimi i SNK 32 është të ndjekë kërkesat e SNK 12 për kontabilizimin e tatimit fitimit që lidhet me shpërndarjen tek mbajtësit e instrumenteve të kapitalit dhe me koston e transaksionit për një transaksion kapitali.

Informacioni i segmentit për totalin e aktiveve dhe detyrimeve:

- sqaron se totali i aktiveve dhe detyrimeve për një segment raportues të veçantë kërkohet të jetë i paraqitur në shënimet shpjeguese, vetëm nëse: (i) një matje e totalit të aktiveve ose totalit të detyrimeve (ose të dyja bashkë) i është siguruar rregullisht drejtuesit të vendimeve operative; (ii) ka patur një ndryshim material nga matje të paraqitura në pasqyrat financiare vjetore të fundit në lidhje me atë segment raportues.

Përmirësimet vjetore të përmendura më sipër janë efektive për periudhat vjetore që fillojnë më 1 janar 2013 dhe më pas. Drejtimi nuk parashikon një ndikim material nga këto ndryshime në pasqyrat individuale financiare të shoqërisë.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.3 Klasifikimi i produktit

Produktet e shoqërisë janë klasifikuar në fillim, për qëllime kontabilizimi, si kontrata të sigurimit. Një kontratë, e cila është klasifikuar si një kontratë sigurimi mbetet si e tillë derisa të gjitha të drejtat dhe detyrimet të kenë përfunduar, ose nuk janë më të vlefshme.

Kontratat sipas të cilave, shoqëria pranon rrezik domethënës sigurimi, nga një palë tjetër (policë-mbajtësi), duke rënë dakord për të kompensuar policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë, nëse një ngjarje specifike e pasigurt në të ardhmen (ngjarja e siguar), ndikon policë-mbajtësin ose përfitues të tjerë; janë klasifikuar si kontrata sigurimi. Rreziku i sigurimit ndryshon nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimit në të ardhmen në një ose më shumë norma interesi specifike, çmime sigurie, çmime produkti, ndryshime në kurset e këmbimit, çmimet ose normat e indeksit, normat, indekset ose variabla të tjerë të kreditimit, të parashikuara në rastin e variablave jo financiar si variabla që nuk janë specifik për një pjesë të kontratës. Kontratat e sigurimit gjithashtu mund të sjellin rrezik financiar.

Pasi një kontratë është klasifikuar si kontratë sigurimi, ajo mbetet e tillë për pjesën e mbetur të jetës, edhe në qoftë se rreziku i sigurimit është zvogëluar ndjeshëm gjatë kësaj periudhe, përveç se në rastet kur të gjitha të drejtat dhe detyrimet kanë përfunduar ose nuk janë më të vlefshme. Kontratat e investimit mund të rriklassifikohen si kontrata sigurimi pas krijimit të tyre, në qoftë se rreziku i sigurimit bëhet domethënëse.

2.4 Njohja dhe matja e kontratave

i. Primet

Primet nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Primet e shkruara përfshijnë primet në kontrata që e kanë filluesën në vitin financiar aktual, pavarësisht nëse lidhen me një pjesë ose tërësisht me periudhat e ardhshme kontabël. Primet përfshijnë komisionet e pagueshme ndaj ndërmjetësve dhe paraqiten neto nga taksat e pagueshme mbi to. Pjesa e fituar e primeve të shkruara njihet si e ardhur. Primet janë fituar që nga data kur shoqëria ndërmerr rrezikun, gjatë periudhës së demit, bazuar në modelin e rrezikut të nënshkruar.

Rezerva për primet e pa-fituara

Rezerva për primet e pa-fituara përfshin pjesën e primit të shkruar bruto e cila është parashikuar të fitohet në vitin pasardhës financiar duke përdorur bazë ditore (metodën 1/365), e përshtatur sipas nevojës për të reflektuar ndonjë ndryshim në rrezikun e ndodhjes së demit gjatë periudhës së mbuluar nga kontrata. Rezerva për primet e pa-fituara për kartonin jeshil, TPL, policat kufitare llogaritet mbi primin e rrezikut si është parashikuar në Vendimet e Bordit të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare të nxjerra gjatë vitit 2013.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.4 Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)

i. Demet

Dëmet e ndodhura nga aktiviteti i përgjithshëm i sigurimit

Dëmet e ndodhura nga sigurimet gjatë aktivitetit të përgjithshëm të sigurimeve përbëhen nga dëmet e paguara për policë-mbajtësit gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimet në vlerësimin e detyrimeve për dëmet pezull. Dëmet pezull përfshijnë rezervat për parashikimet e shoqërisë për shlyerjen përfundimtare të gjitha dëmeve të ndodhura por të pa paguara në datën e raportimit, të raportuara ose jo, shpenzimet e brendshme ose të jashtme për dëmet si dhe nga një marzh sigurie.

Ndërsa drejtuesit konsiderojnë që rezerva bruto për dëmet dhe mbulimet e risigurimit të lidhura me to janë përcaktuar saktë mbi baza të informacionit aktual të mundshëm për to, detyrimi më i fundit mund të variojë si rezultat i informacionit dhe ngjarjeve në vijimësi dhe mund të rezultojë në korrigjime domethënëse të shumave të rezervuara. Korrigjimet e shumave të rezervave të dëmeve të vendosura në vitet paraardhës janë reflektuar në pasqyrat financiare të periudhës tek të cilat janë bërë rishikimet.

Rezerva e dëmeve

Rezerva e dëmeve përfaqëson koston përfundimtare të vlerësuar të shlyerjes së të gjitha dëmeve, duke përfshirë kostot direkte dhe indirekte të shlyerjes së dëmit, të cilat lindin nga ngjarje që kanë ndodhur deri në datën e raportimit. Humbjet e papaguara dhe rregullimet e shpenzimeve të humbjes përbëhen nga vlerësime për humbjet e raportuara dhe rezervat për humbjet e paraportuara. Metoda e përdorur për të përcaktuar rezervën e dëmeve, është bazuar në rregullat ligjore të mëposhtme si dhe mbështetur gjithashtu edhe nga vlerësimet aktuariale.

Rezervat e sigurimit më 31 dhjetor 2013, janë ekuivalente me ato të aprovuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me Nenin 101, 111, dhe 112, pika 1 (c), 2 dhe 3 të Ligjit “Mbi Aktivitetin e Sigurimit, Risigurimit dhe Ndërmjetësimeve në Sigurime dhe Risigurime” Nr. 9267 datë 29 korrik 2004, dhe Neni 14, pika 9 i Ligjit “Mbi organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve” Nr. 9572, datë 3 korrik 2006.

Në përputhje me Ligjin Shqiptar të Sigurimeve dhe direktivave të tjera të lidhura me të, rezerva për dëmet e raportuara por jo të paguara (“RBNS”) përcaktohet duke u zbatuar në çdo rast individualisht në përputhje me praktikën më të mira të specialistëve të sigurimit. Rezerva është llogaritur si shuma e pritur për të paguar dëmin dhe parashikimet janë korrigjuar sipas informacionit më të ri të mundshëm. Rezerva e ndodhur por e pa raportuar (IBNR) është vlerësuar bazuar në metodën e Raportit të Thjeshtë bazuar në krahasimin e dëmeve të raportuara në vitin e vëzhguar dhe të ndodhura në vitet paraardhëse.

ii. Risigurimi

Shoqëria cedon primet e sigurimit dhe rrezikun me qëllim për të limituar humbjet e mundshme nëpërmjet diversifikimit e rreziqe të saj të lindura nga linjat e biznesit si TPL, Prona, Kartoni Jeshil, Kasko, marina dhe aviacioni.

Risigurimi është paraqitur bruto në pasqyrën e pozicionit financiar. Aktivitetet e risigurimit përfshijnë shumat për t’u arkëtuar nga shoqëritë e risigurimit për humbjet e paguara dhe të papaguara si dhe shpenzimet e rregullimit të dëmeve por nuk përfshijnë primet e pa-fituara të risiguruara. Shoqëria llogarit primet e ceduara duke u bazuar në primet e shkruara bruto dhe shpenzimet që lidhen në mënyrë direkte me primet. Aktivitetet e risigurimit regjistrohen për primet e pa-fituara të ceduara. Shumat e rikuperueshme nga risiguresit vlerësohen në një mënyrë të qëndrueshme me detyrimet për dëmet dhe me politikën e risigurimit.

2. Politikat kontabël (vazhdim)

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2.4 Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)

iii. Testi i mjaftueshmërisë së rezervave

Në çdo datë raportimi shoqëria kryen testimin për tu siguruar për mjaftueshmërinë e rezervave të dëmeve. Testimet kryesore që kryen janë: Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analiza e Zhvillimit të Provigjioneve të Dëmeve.

Analiza e Raportit të Dëmeve kryhet çdo vit dhe individualisht në pjesën më të madhe të linjave të biznesit. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet dhe mbi dëmet që përfshijnë edhe koston e marrjes në sigurim dhe kosto të tjera të jashtme të lidhura me dëmin. Në kryerjen e kësaj analize shoqëria merr në konsideratë parashikimet aktuale të rrjedhjeve dalëse të parasë. Shoqëria nuk i skonton këto rrjedhje të parashikuara të parasë sepse shumica e dëmeve priten të paguhen brenda vitit.

Në vazhdim, shoqëria kryen një analizë vjetore të zhvillimit të Provigjonimit të dëmeve për vlerësimin e metodologjisë së Provigjonimit. Kjo analizë kryet mbi RBNS dhe IBNR në baza individuale dhe të kombinuara. Në rast se analiza shfaq mospërputhje të madhe, korrigjimet e duhura bëhen në metodën e provigjonimit. Nëse identifikohet një pamjaftueshmëri e rezervave, ajo do t'i ngarkohet menjëherë shpenzimeve duke krijuar një rezervë rreziku të paskaduar nga humbjet që rezultojnë nga Testi i Mjaftueshmërisë së Rezervave.

2.5 Kostot e marrjes në sigurim

Kostot e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që lindin nga lidhja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë kostot direkte, si komisionet e blerjes dhe kosto e hartimit të dokumenteve të sigurimit.

Kostot e dëmeve konsistojnë në shpenzimet e jashtme të dëmit dhe nuk përfshijnë shpenzime të brendshme të dëmit të cilat janë menduar për të mos qenë të rëndësishme krahasuar me kostot e jashtme. Shoqëria krijon një tolerancë për menaxhimin e kostove të dëmeve brenda rezervave që lidhen me dëmet. Kostot e marrjes në sigurim paraqesin kostot direkte të jashtme siç janë komisionet e agjentëve, kostot e botimeve dhe marketingut. Këto kosto shtyhen si një zvogëlim nga rezerva e primeve të pa-fituara.

Kostot direkte të marrjes në sigurim prezantohen si kosto të shtyra bazuar në termat e policës në fuqi me një metodë në përputhje me përllogaritjen e rezervës së primit të pa-fituar. Kostot e shtyra të marrjes në sigurim prezantohen si zë më vete në pasqyrën e pozicionit financiar.

2.6 Transaksione në monedhë të huaj

i. Monedha funksionale dhe e prezantimit

Zërat e përfshirë në pasqyrat financiare të njëjësive të shoqërisë janë matur duke përdorur monedhën kryesore ekonomike të vendit ku operon njësia (monedha funksionale).

Pasqyrat financiare individuale janë paraqitur në lekë, që është dhe monedha funksionale e shoqërisë.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.6 Transaksione në monedhë të huaj (vazhdim)

iii. Transaksionet dhe tepricat e llogarive

Transaksionet në monedhë të huaj regjistrohen me kurset e këmbimit në datën e transaksionit. Në çdo datë raportimi, aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj rivlerësohen me kurset e datës së raportimit. Diferencat nga këmbimet valutore njihen në fitim ose humbje të periudhës në të cilën ndodhin.

Kursi zyrtar i zbatueshëm i Bankës së Shqipërisë (lekë kundrejt monedhës së huaj) për monedhat kryesore të përdorura më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2013		31 dhjetor 2012	
	Mesatare	Mbyllje	Mesatare	Mbyllje
Dollar amerikan (USD)	105.41	101.86	108.23	105.85
Njësia monetare e BE (EUR)	140.96	140.20	139.01	139.59

2.7 Njohja e të ardhurave

i. Prime të shkruara bruto

Primet bruto të shkruara janë njohur sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara për kontratat e sigurimit, policat e lëshuara gjatë vitit janë kredituar sipas realizimit proporcional duke u bazuar në termat e kontratës së sigurimit. Rezerva e primeve të pa-fituara përfaqëson pjesën e primeve të shkruara që lidhen me termat e mbulimit që nuk kanë skaduar.

ii. Të ardhura nga interesi

E ardhura nga interesi njihet në bazë të drejtave të konstatuara mbi principalin, duke përdorur normën efektive të interesit.

iii. Të ardhura nga qiraja

Të ardhurat nga qiraja njihen me bazë rrjedhëse.

2.8 Shpenzimet

i. Shpenzimet operative

Shpenzimet operative njihen kur ato ndodhin.

ii. Përfitimet e punonjësve

Kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore

Shoqëria paguan vetëm kontributet e detyrueshme të sigurimeve shoqërore të cilat u sigurojnë punonjësve përfitime pensioni pas shkëputjes nga puna. Autoritetet lokale janë përgjegjëse për të përcaktuar kufirin e vendosur minimal për pensionet në vendet përkatëse sipas një plani të përcaktuar kontributesh pensioni. Kontributet e shoqërisë për planin e pensionit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse kur ndodhin.

iii. Pagesat e qirasë operative

Pagesat e bëra për qiratë operative njihen pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse në përpjesëtim me kohëzgjatjen e kontratës së qirasë.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.9 Instrumentet financiare

(a) Aktivet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Kjo kategori ka dy nën-kategori: aktive financiare të mbajtura për shitje dhe ato të dizenuara me vlerën e drejtë përmes fitimit dhe humbjes që në njohjen fillestare. Një aktiv financiar është i klasifikuar në kategorinë e “aktiveve financiare me vlerë të drejtë përmes humbjes apo fitimit” që në fillim nëse është blerë me qëllim për t’u shitur në një periudhë afat – shkurtër nëse është pjesë e një portofoli të aktiveve financiare për të cilat ka të dhëna për përfitim afat-shkurtër, ose nëse është përcaktuar kështu nga drejtuesit e shoqërisë. Shoqëria nuk ka asnjë aktiv të klasifikuar në këtë kategori në ditën e raportimit.

(b) Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë aktive financiare jo derivativë me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv letrash me vlerë përveç atyre që shoqëria do të shesë në një periudhë afat – shkurtër ose i ka klasifikuar si aktive financiare me vlerë të drejtë përmes humbjes apo fitimit ose si gati për shitje. Huatë dhe të arkëtueshmet janë njohur fillimisht me vlerë të drejtë dhe më pas janë vlerësuar me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjonet për zhvlerësim. Një provigjon për zhvlerësim i huave dhe të arkëtueshmeve përcaktohet kur ka kushte objektive së shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumat e kërkuara të përcaktuara në termat fillestar. Të arkëtueshmet që lindin nga kontratat e sigurimit janë të klasifikuara në këtë kategori dhe rishikohen për zhvlerësimin si pjesë rishikimit për zhvlerësim që i bëhet huave dhe të arkëtueshmeve.

(c) Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim

Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim janë aktive financiare jo derivative me pagese fikse ose të përcaktuar dhe maturitet të pandryshueshëm, përveç atyre që klasifikohen si hua dhe të arkëtueshme, të cilat drejtimi i shoqërisë ka qëllimin dhe mundësinë për t’i mbajtur deri në maturim. Këto aktive njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe më pas vlerësohen me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv minus provigjonet për zhvlerësim nëse ka. Një provigjon për zhvlerësimin e letrave me vlerë të borxhit që mbahet deri në maturim përcaktohet kur ekzistojnë kushte objektive se shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë shumat e arkëtueshme të përcaktuara në termat fillestar.

(d) Aktivet financiare të vlefshme për shitje

Aktivet financiare të vlefshme për shitje janë aktive financiare jo derivative që janë të klasifikuara në këtë kategori ose që nuk janë të klasifikuara në asnjë kategori tjetër. Shoqëria nuk ka asnjë aktiv të klasifikuar në këtë kategori në ditën e raportimit.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Njohja fillestare dhe çregjistrimi

Blerjet dhe shitjet në mënyrë të rregullt të aktiveve financiare njihen në ditën e tregtimit, dita në cilën shoqëria angazhohet në blerjen ose shitjen e aktivit. Aktivet financiare janë njohur fillimisht me vlerën e drejtë plus, në rastin e të gjitha aktiveve financiare që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, kostot e transaksionit që janë të lidhura drejtpërdrejt me blerjen e tyre. Aktivet financiare të mbajtura me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbje, njihen fillimisht me vlerën e drejtë, dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Aktivitetet financiare çregjistrohen, kur të drejtat për të përfituar flukse të mjeteve monetare prej tyre kanë skaduar ose kur ata janë transferuar dhe shoqëria ka transferuar në mënyrë thelbësore të gjitha rreziqet dhe përfitimet e pronësisë mbi aktivin.

Matja ne vijim

Aktivitetet financiare të disponueshme për shitje dhe aktivitetet financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes maten edhe më pas me vlerën e drejtë. Huatë, të arkëtueshmet, dhe investimet e mbajtura deri në maturim maten me koston e amortizuar duke përdorur metodën e interesit efektiv. Fitimet dhe humbjet e realizuara dhe të porealizuara që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të "aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes" janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën ato lindin. Fitimet dhe humbjet e porealizuara që rrjedhin nga ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë të klasifikuara si aktive financiare të vlefshme për shitje janë njohur në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Kur letrat me vlerë të klasifikuara si aktive financiare për shitje janë shitur ose zhvlerësuar, rregullimet e akumuluar të vlerës së drejtë përfshihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si fitim ose humbje neto nga aktivitetet financiare.

Fitimet ose humbjet që rezultojnë nga ndryshimet në vlerën e drejtë në kategorinë "aktiveve financiare me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes" janë paraqitur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën ato lindin. Ndryshimet në vlerën e drejtë të instrumenteve të klasifikuara si të vlefshme për shitje njihen në të ardhurat e tjera gjithëpërfshirëse.

Interesi nga aktivitetet financiare gati për shitje llogaritet duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Dividendët nga aktivitetet financiare gati për shitje janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur e drejta e shoqërisë për të marrë pagesa është përcaktuar. Të dy rastet e mësipërm janë përfshirë në rreshtin e të ardhurave nga investimet.

Vlera e drejtë e aktiveve të kuotuar është bazuar në çmimet e ofertës aktuale. Në qoftë se tregu për një aktiv financiar nuk është aktiv, shoqëria e përcakton vlerën e drejtë duke përdorur teknika të ndryshme vlerësimi. Këto përfshijnë përdorimin e transaksioneve në kushte tregu, referenca për instrumente të tjera që janë në thelb të njëjta, analiza e skontimit të flukseve monetare, etj.

Netimi i instrumenteve financiare

Aktivitetet dhe detyrimet financiare raportohen të netuara në pasqyrat e pozicionit financiar vetëm kur ekziston një e drejtë ligjërishme e zbatueshme për të netuar shumat e njohura dhe ka një qëllim për t'i mbajtur ato mbi bazë neto, ose të njohësh aktivin dhe të shlyesh detyrimin në të njëjtën kohë.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.9 Instrumentet financiare (vazhdim)

Investime në letra me vlerë

Investimet në letra me vlerë janë instrumente borxhi për të cilat shoqëria ka qëllimin dhe aftësinë që ti mbajë deri në maturim dhe ti klasifikojë si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet, të cilat kanë pagesa fikse apo të përcaktuara dhe të cilat mbahen deri në maturim maten në vijim me koston e amortizuar minus provigjonin për zhvlerësim. Kostoja e amortizuar llogaritet duke marrë në konsideratë çdo zbritje ose prim në blerje.

Instrumente kapitali

Instrumentet e kapitalit janë aktive financiare të cilat nuk kanë një çmim tregu në një treg aktiv dhe vlera e drejtë e tyre nuk mund të matet në mënyrë të besueshme prandaj maten me kosto.

Depozita me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar në shumën e principalit të papaguar dhe klasifikohen sipas maturitetit. Depozitat me afat me maturitet më të shkurtër se tre muaj klasifikohen si mjete monetare dhe ekuivalente të tyre, ato me maturitet mbi tre muaj klasifikohen si investime në depozita me afat. Interesi llogaritet me bazë rrjedhëse.

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Për qëllimin e përgatitjes së pasqyrës së pozicionit financiar dhe pasqyrës së flukseve të parasë, mjetet monetare përfshijnë arkën dhe gjendjet e llogarive bankare me maturitet më pak se 3 muaj dhe pa rrezik të konsiderueshëm të ndryshimit në vlerë.

2.10 Aktivet afatgjata materiale

Njohja dhe matja

Aktivët afatgjata materiale mbahen me koston e tyre historike minus zhvlerësimin e akumuluar dhe çdo humbje tjetër nga zhvlerësimi. Kostoja historike përmban shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit afat-gjatë.

Kur pjesë të një aktivi kanë diferenca mbi jetëgjatësinë e dobishmërisë, ato njihen si aktive të ndara (komponentë të rëndësishëm) të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar të ardhurat nga shitja me vlerën kontabël dhe njihen si “Të tjera (shpenzime / të ardhura)” në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kostot në vazhdim

Kostot në vazhdim përfshihen në vlerën e aktivit ose njihen si një aktiv i veçantë vetëm kur është e mundshme që benefite të ardhshme do të rrjedhin nga ky aktiv dhe kostoja mund të matet në mënyrë të besueshme. Vlera kontabël e pjesës së zëvendësuar nuk njihet. Të gjitha riparimet dhe mirëmbajtja i ngarkohen fitimit dhe humbjes së periudhës financiare në të cilën ato kryhen.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.10 Aktivet afatgjata materiale (vazhdim)

Zhvlerësimi

Zhvlerësimi për ndërtesat dhe përmirësimet e infrastrukturës llogaritet duke përdorur metodën lineare në përputhjen me jetën e dobishme ekonomike të aktivitetit ndërsa amortizimi për zërat e tjerë të aktiveve llogaritet duke përdorur metodën me vlerën e mbetur në përputhje me jetën e dobishme ekonomike të aktivitetit. Toka dhe aktivet në ndërtim nuk amortizohen.

Zhvlerësimi vjetor i aktiveve afatgjata materiale sipas jetëgjatësisë së dobishme të parashikuar për periudhën e mëparshme dhe aktuale paraqitet si më poshtë:

Në 31 dhjetor	2013	2012
Ndërtesat	5%	5%
Mjete transporti	20%	20%
Mobilie dhe pajisje zyre	20%	20%
Pajisje dhe programe kompjuterike	25%	25%

2.11 Aktive për investim

Aktivet për investim janë aktive të cilat mbahen për të fituar të ardhura nga qiraja ose nga vlerësimi kapital i tyre por nuk përdoren në rrjedhën normale të biznesit, në prodhimin e mallrave apo ofrimit të shërbimeve ose për qëllime administrative. Aktivet për investim në njohjen fillestare maten me kosto dhe për njohjen në vijim shoqëria ka zgjedhur modelin e kostos. Për matjen e aktiveve për investim shoqëria bazohet në kërkesat e SNK 16 për këtë model.

Aktivet për investim të blera nga shoqëria paraqiten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi, nëse ka. Amortizimi ngarkohet në fitim ose humbje sipas metodës lineare në përputhje me jetën e dobishme ekonomike të çdo zëri të aktiveve për investim. Jeta e dobishme e aktiveve për investim është 20 vjet.

2.12 Aktive afatgjata jo-materiale

Aktivet afatgjata jo-materiale që janë të blera nga shoqëria, të cilat kanë një jetë të dobishme të kufizuar, vlerësohen me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe rënien e akumuluar në vlerë. Norma e amortizimit është 25% bazuar në vlerën e mbetur të aktivitetit.

Shpenzimet e mëpasshme

Shpenzimet e mëpasshme kapitalizohen vetëm nëse shpenzimi rrit përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara në aktivin me të cilin ka të bëjë shpenzimi. Të gjitha shpenzimet, duke përfshirë shpenzime për emrin e mirë të gjeneruar nga shoqëria apo markat, njihen në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

Amortizimi

Amortizimi njihet në pasqyrën gjithëpërfshirëse të ardhurave bazuar në vlerën e mbetur duke përdorur normat fiskale për amortizimin e aktiveve të trupëzuara, një muaj pas blerjes së aktivitetit. Jeta e dobishme e aktiveve rishikohet, dhe bëhen rregullimet e nevojshme, në çdo datë raportimi. Fitimet dhe humbjet nga shitja përcaktohen duke krahasuar shitjet me vlerën e mbetur dhe diferencat përfshihen në pasqyrën gjithëpërfshirëse të ardhurave.

2.13 Llogari të arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera mbahen me koston e tyre minus humbjet nga rënia e vlerës.

2.14 Llogari të pagueshme të sigurimit dhe të tjera

Llogaritë e pagueshme të sigurimit dhe të tjera mbahen me kosto te amortizuar.

2.15 Humbjet nga zhvlerësimi

i. Aktivet financiare të mbajtura me koston e amortizuar

Në çdo datë të pasqyrës së pozicionit financiar, shoqëria vlerëson nëse ka prova objektive që aktivet financiare ose një grup i aktiveve financiare është zhvlerësuar. Një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare zhvlerësohet dhe humbjet nga zhvlerësimi njihen vetëm nëse ekzistojnë prova objektive të zhvlerësimit si rezultat i një ose më shumë ngjarjeve që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të aktivitetit (një 'ngjarje humbje') dhe ngjarja e humbjes (ose ngjarjet) ka ndikim në flukset e ardhshme të vlerësuara të aktivitetit financiar ose të një grupi aktivesh financiare që mund të vlerësohet me besueshmëri.

Dëshmi objektive që një aktiv financiar ose grup aktivesh është zhvlerësuar përfshin të dhëna të vëzhgueshme që vijnë në vëmendjen e shoqërisë në lidhje me ngjarjet e mëposhtme:

- a) Vështirësi të konsiderueshme financiare të emetuesit ose të debitorit;
- b) Shkelja e kontratës, si vonesa në pagesa e penalitete;
- c) Mundësia që emetuesi ose debitori do të hyjë në proces falimentimi ose riorganizime të tjera financiare;
- d) Zhdukja e një tregu aktiv për aktivin financiar për shkak të vështirësive financiare,

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.15 Humbje nga zhvlerësimi (vazhdim)

- e) Të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare nga një grup i aktiveve financiare që nga njohja fillestare e tyre, megjithëse rënia ende nuk mund të identifikohet specifikisht me një aktiv financiar të Shoqërisë, duke përfshirë:
 - Ndryshimet jo të favorshme në statusin e pagesës së emetuesit ose të debitorit në Shoqëri, ose
 - Kushte ekonomike kombëtare apo lokale ekonomike që lidhen me mos pagesën e aktivitetit të Shoqërisë

Në fillim, shoqëria konsideron nëse ekzistojnë prova objektive individuale të zhvlerësimit për aktivet financiare dhe janë individualisht të konsiderueshme. Nëse shoqëria përcakton se nuk ka prova objektive të zhvlerësimit për një aktiv financiar të testuar individualisht, i konsiderueshëm apo jo, e bashkon aktivin në një grup aktivesh financiare me rrezik krediti të njëjtë dhe në mënyrë kolektive i teston për zhvlerësim. Aktivitetet që janë të testuara në mënyrë individuale dhe për të cilat një humbje nga zhvlerësimi ekziston ose vazhdon të njihet nuk bashkohen me aktivet e tjera që testohen në mënyrë kolektive.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Nëse ekziston evidencë objektive që një humbje nga zhvlerësimi është krijuar për huatë dhe të arkëtueshmet ose nga aktivet financiare të mbajtura deri në maturitet që mbahen me kosto të amortizuara, shuma e humbjes matet si diferencë midis vlerës kontabël të aktivitetit dhe vlerës aktuale të flukseve të ardhshme monetare të vlerësuara (duke përjashtuar humbjet e ardhshme të kredisë që kanë ndodhur) të skontuara me normën fillestare të interesit efektiv të aktivitetit financiar. Vlera kontabël e aktivitetit zvogëlohet nëpërmjet përdorimit të një llogarie rezervë, dhe shuma e zhvlerësimit njihet në fitim ose humbje. Nëse një investim i mbajtur në maturim ose një hua ka një normë të ndryshueshme të interesit, norma e skontimit për matjen e zhvlerësimit është norma aktuale efektive e interesit e përcaktuar sipas kontratës.

Si praktike e njohur, shoqëria mund të masë zhvlerësimin e një instrumenti financiar në bazë të vlerës së drejtë duke përdorur një çmim të vëzhguar të tregut.

Për qëllim të testimit kolektiv për zhvlerësim, aktivet financiare grupohen sipas karakteristikave të ngjashme të rrezikut të kreditit (p.sh., në bazë të procesit të vlerësimit të shoqërisë që konsideron llojin e aktivitetit, industrinë, pozicionin geografik, statusin e pagesave, dhe faktorë të tjerë të lidhur).

Këto karakteristika janë të rëndësishme për vlerësimin e flukseve monetare të ardhshme për grupe të tilla aktivesh duke qenë tregues i aftësisë së emetuesit për të paguar të gjitha shumat sipas kushteve kontraktuale të instrumentit të borxhit nën vlerësim.

Në qoftë se në një periudhë të mëvonshme, shuma e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet dhe zvogëlimi mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pasi zhvlerësimi ishte njohur (të tilla si përmirësimi i indeksit të kreditit), humbja e njohur më parë nga zhvlerësimi ndryshohet duke rregulluar llogarinë e rezervës. Shuma e ndryshimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

2. Politikat kontabël (vazhdim)

ii. Aktivet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë

Shoqëria vlerëson në çdo datë të Pasqyrës së pozicionit financiar nëse ka evidencë objektive që një aktiv financiar gati për shitje është zhvlerësuar, duke përfshirë në këtë rast instrumentet e kapitalit gati për shitje që kanë një rënie të konsiderueshme ose të zgjatur në vlerën e drejtë të letrës me vlerë nën koston e saj. Nëse ndonjë evidencë e tillë ekziston për aktivet financiar gati për shitje, humbja e akumuluar – e matur si diferencë midis koston së blerjes dhe vlerës aktuale të drejtë, duke zbritur humbjet nga zhvlerësimi për aktivin financiar të njohur më parë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve - hiqet nga kapitali dhe njihet si fitim ose humbje. Humbjet nga zhvlerësimet të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si fitim ose humbje për instrumentet e kapitalit nuk mund të s'tornohen më pas. Humbja nga zhvlerësimi mund të s'tornohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, në qoftë se në një periudhë të mëvonshme vlera e drejtë e një instrumenti të borxhit të klasifikuar si gati për shitje rritet dhe rritja mund të lidhet objektivisht me ngjarje që ndodhin pas humbjes nga zhvlerësimi që është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

iii. Zhvlerësimi i aktiveve jo-financiare

Aktivitet jo-materiale që kanë një jetë të dobishme të pafundme, për shembull tokë, nuk janë subjekt amortizimi dhe janë testuar çdo vit për zhvlerësim. Aktivitet jo-materiale që janë subjekt amortizimi janë rishikuar për zhvlerësim sa herë që ngjarje apo ndryshime në rrethanat tregojnë se vlera kontabël nuk mund të jetë e rikuperueshme. Një humbje nga zhvlerësimi njihet në masën që vlera kontabël e aktivitetit e tejkalon shumën e tij të rikuperueshme. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë midis vlerës së drejtë të aktivitetit minus koston e shitjes dhe vlerës në përdorim. Për qëllime të vlerësimit të

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

zhvlerësimet, aktivet janë të grupuara në nivelet më të ulëta për të cilat janë të identifikueshme veçmas flukse monetare (njësitë gjeneruese të mjeteve monetare).

2.16 Tatimi mbi fitimin

Tatimi mbi fitimin është njohur në pasqyrën e të ardhurave gjithëpërfshirëse dhe paraqet shumën e tatimeve të pagueshme dhe të shtyra.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, i cili llogaritet duke përdorur normat e tatimeve në fuqi në datën e raportimit dhe ndonjë rregullim të tatimit të pagueshëm në lidhje me vitet e mëparshme. Fitimi fiskal ndryshon nga fitimi neto i raportuar në fitim ose humbje sepse përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që janë të tatueshme ose të zbritshme në vitet e tjera dhe gjithashtu përjashton zërat e të ardhurave dhe shpenzimeve që nuk janë asnjëherë të tatueshme ose të zbritshme. Tatimi i shtyrë kontabilizohet duke përdorur metodën e detyrimeve të bilancit kontabël dhe llogaritet si tatimi i pritshëm për tu paguar ose për tu arkëtuar nga diferencat e përkohshme midis vlerës së mbartur të aktiveve dhe detyrimeve për qëllime raportimi financiar dhe vlerës së përdorur për qëllime fiskale. Shuma e tatimit të shtyrë të lejuar bazohet në mënyrën e parashikuar të realizimit ose pagesës të shumave të mbartura të aktiveve dhe detyrimeve, duke përdorur normat fiskale të miratuara ose që priten të miratohen me siguri në datën e raportimit. Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme dhe aktivet tatimore të shtyra njihen vetëm nëse është e mundur që në të ardhmen do të ketë përfitime fiskale kundrejt të cilave do të mund të shfrytëzohen diferencat e përkohshme. Aktivet tatimore të shtyra reduktohen kur nuk ka mundësi që përfitimet e lidhura tatimore do të realizohen. Tatimi i shtyrë llogaritet me normën e taksës që është parashikuar për tu zbatuar në periudhën kur detyrimi paguhet ose aktivi të realizohet dhe ngarkohet në pasqyrën përmbledhëse individuale të ardhurave, përveç kur është e lidhur me zërat e ngarkuar direkt në kapital. Në të tilla raste tatimi i shtyrë është gjithashtu pjesë e kapitalit.

2. Politikat kontabël (vazhdim)

2.17 Transaksionet me palët e lidhura

Palët e lidhura përbëhen nga aksionare dhe drejtorët e shoqërisë, së bashku me entitete që ata kontrollojnë, të cilët mund të ushtrojnë influencë të konsiderueshme në operacionet dhe menaxhimin e shoqërisë. Duke konsideruar çdo palë të mundshme të tretë vëmendje i kushtohet thelbit të marrëdhënies dhe jo vetëm forma ligjore.

2.18 Ngjarjet pas datës së raportimit

Ngjarjet pas datës së bilancit që ofrojnë informacion shtesë për pozicionin e shoqërisë në datën e Pasqyrës së pozicionit financiare (veprimet rregulluese), janë të reflektuara në pasqyrat financiare. Ngjarjet pas datës së bilancit që nuk janë ngjarje për veprime rregulluese janë pasqyruar në shënimet shpjeguese kur janë materiale.

2.19 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Detyrimet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare. Ato pasqyrohen në shënimet shpjeguese nëse mundësia e konsumimit të burimeve që kanë përfitime ekonomike është e ulët. Aktivet e kushtëzuara nuk njihen në pasqyrat financiare por paraqiten në shënimet sqaruese kur mundësia e të ardhurave ekonomike është e mundshme.

Shuma e humbjes së kushtëzuar njihet si provigjon nëse është e mundshme që ngjarje të ardhshme do të konfirmojnë në provigjonin, një detyrim njihet në ditën e Pasqyrës së pozicionit financiar kur një vlerësim i pranueshëm i humbjes mund të bëhet në mënyrë të besueshme.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

3 Gjykime kontabël dhe burimet kryesore të pasigurisë së vlerësimit

Në aplikimin e politikave kontabël të shoqërisë, nga drejtimi kërkohet që të bëjë gjykime, vlerësime, dhe supozime për vlerën e mbartur të aktiveve dhe detyrimeve që nuk janë të qarta nga burime të tjera. Vlerësimet dhe supozimet e bashkuara janë bazuar në eksperiencën historike dhe faktorëve të tjerë që janë konsideruar relevantë. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimi i detyrimit të kontratave të sigurimit

Për kontratat e jo-jetës, vlerësimet duhet të bëhen për kostot finale të pritura për dëmet e raportuara në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar dhe për kostot finale të pritura për dëmet e shfaqura por që ende nuk janë raportuar në datën e Pasqyrës së pozicionit financiar (IBNR). Kostot finale të dëmeve pezull është vlerësuar duke përdorur disa standarde të teknikave projektuese të aktuarit për dëme. Supozimi kryesor për këto teknika është që eksperiencat e shkuara të shoqërisë në lidhje me dëmet, mund të përdoret për projektimin e dëmeve të ardhshme dhe kështu të vlerësojë kostot finale të dëmeve. Si të tilla, këto metoda ekstrapolojnë zhvillimin e humbjeve të ndodhura dhe të paguara, kostot mesatare për dëme dhe numri i dëmeve bazuar në zhvillimet e vëzhguara të viteve të shkuara dhe koeficienteve të humbjes së pritur. Zhvillimi i dëmeve në bazë historike zakonisht është analizuar sipas viteve të aksidenteve, por mundet të analizohet edhe sipas sipërfaqes gjeografike, gjithashtu sipas linjave domethënëse të biznesit dhe llojit të demit. Veç kësaj, gjykim kualitativ është përdorur për të vlerësuar zgjatjen në të cilën trendët e kaluara mund të mos aplikohen në të ardhmen, në mënyrë që arrijnë vlerësimet e kostos finale të dëmeve që paraqesin një gjasë rezultati nga intervali i rezultateve të mundshme, duke marrë parasysh të gjitha pasiguritë e përfshira.

Humbjet nga zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme

Shoqëria rishikon çdo vit për zhvlerësim llogaritë e saj të arkëtueshme që lidhen ose nuk lidhen me sigurimet. Për të përcaktuar se nëse një humbje nga zhvlerësimi duhet regjistruar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, shoqëria gjykon nëse ekzistojnë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një rënie në flukset e ardhshme monetare të vlerësuara për një grup llogarish të arkëtueshme përpara se rënia të mund të identifikohet me një debitor individual në atë portofol. Kjo evidence mund të përfshijë të dhëna të vëzhgueshme që tregojnë se ka një ndryshim negativ në statusin pages të debitorit që lidhet me mos pagesën e një llogarie të arkëtueshme në grup. Drejtimi përdor vlerësime të bazuara në eksperiencat e mëparshme për aktive me karakteristika rreziku dhe ngjarje zhvlerësimi të ngjashme me ato të portofolit kur përcaktohen flukset e ardhshme të aktiveve monetar.

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

4 Aktivet afatgjata materiale

Aktivitet afat-gjata materiale më 31 dhjetor 2013 janë paraqitur si më poshtë:

	Kioska	Pajisje Kompjuterie	Mjete Transporti	Pajisje Zyre	Total
Kosto Historike					
Me 1 Janar 2013	13,416,673	48,690,779	29,351,656	44,740,484	136,199,592
Shtesa	-	179,148	-	333,066	512,214
Pakesime	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-
Total me 31 Dhjetor 2013	13,416,673	48,869,926	29,351,656	45,073,550	136,711,806
	-	-	-	-	-
Amortizimi i Akumuluar	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-
Me 1 Janar 2013	10,273,432	35,584,600	19,273,416	33,508,024	98,639,472
Shtesa	628,648	3,324,501	2,015,648	2,283,586	8,252,384
Pakesime	-	-	-	-	-
	-	-	-	-	-
Total me 31 Dhjetor 2013	10,902,081	38,909,101	21,289,064	35,791,610	106,891,856
	-	-	-	-	-
Vlera Neto 1 Janar 2013	3,143,241	13,106,179	10,078,241	11,232,460	37,560,120
Total me 31 Dhjetor 2013	2,514,592	9,960,825	8,062,593	9,281,940	29,819,951

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

5 Aktive të mbajtura për investim

Aktivitet e mbajtura për investim përfshijnë : një apartament, një ndërtesë dhe 2 dyqane në Vlorë me kostosi me poshte;

Kosto Historike

Me 1 Janar 2013	516,926,363
Shtesa	-
Pakesime	-
Total me 31 Dhjetor 2013	<u>516,926,363</u>

Amortizimi i akumuluar

Me 1 Janar 2013	(47,981,616)
Shtesa te vitit	(23,447,237)
Pakesime	-
Total me 31 Dhjetor 2013	<u>(71,428,853)</u>

Vlera Neto

Me 1 Janar 2013	468,944,747
Total me 31 Dhjetor 2013	<u>445,497,510</u>

Shoqëria ka zgjedhur 'modelin e kostos' për përlllogaritjen e mëtejshme të aktiviteteve të mbajtura për investim.

6 Aktivitet afat-gjata jo-materiale

Aktivitet afatgjata jo-materiale përfshijnë programe kompjuterike të cilat janë detajuar si më poshtë:

Kosto

Me 1 Janar 2013	6,231,578
Shtesa	768,600
Pakesime	-
Me 31 Dhjetor 2013	<u>7,000,178</u>

Amortizimi i akumuluar

Me 1 Janar 2013	(3,596,108)
Shtesa te vitit	(835,076)
Pakesime	-
Me 31 Dhjetor 2013	<u>(4,431,184)</u>

Vlera Neto

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Me 1 Janar 2013	2,635,470
Me 31 Dhjetor 2013	2,568,994

7 Kategoritë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Vlerat kontabël të aktiveve dhe detyrimeve financiare të shoqërisë të njohura në pasqyrën e pozicionit financiar në periudhën raportuese janë të kategorizuara si më poshtë:

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Aktivet		
<i>Kreditë dhe të arkëtueshme</i>		
Depozitat me afat në banka	494,113,496	499,204,229
Aktivet e risigurimit	13,477,033	92,574,170
Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	167,198,033	241,232,550
llogari të arkëtueshme		
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	7,012,054	16,767,009
	681,800,616	849,777,959
Detyrime		
<i>Detyrime financiare të matura sipas kostos së amortizuar</i>		
Të pagueshme për risigurimet	161,695,388	228,263,109
Llogari të pagueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera	21,345,097	34,864,822
llogari të pagueshme		
	156,707,876	171,130,870
Totali		

8 Depozitat me afat në banka

Detajimi i depozitave me afat sipas bankave është si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Credins Bank	61,706,893	163,550,679
Banka Popullore	98,140,000	130,934,026
National Bank of Greece	8,387,298	8,416,235
Emporiki Bank	77,750,000	12,750,000
Intesa San Paolo	10,607,742	11,137,742
Tirana Bank	120,698,000	120,399,100
Union Bank	41,864,460	43,504,350
BKT	65,000,000	-
Total	484,154,394	490,692,133
Interes I maturuar	9,959,102	8,512,096
Totali I depozitave	494,113,496	499,204,229

Në përputhje me Nenin 98 të ligjit Nr. 9267 “Mbi aktivitetin e sigurimit dhe risigurimit dhe mbi ndërmjetësimet e sigurimit dhe risigurimit” datë 29 korrik 2004 dhe në përputhje me Udhëzimin Nr. 11, datë 25 mars 2006 të Ministrisë së Financës, në lidhje me fondin e garancisë, nëse shoqëria

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

bazuar në klasifikimin e nenit Nr. 7 po të njëjtit ligj, ushtron aktivitetin e saj nën nivelet 10,11,12,13 dhe 15 ,shoqëria mban një minimum të një të tretës së nivelit të kërkuar të nivelit të marzhit të aftësisë paguese ose 100,000,000 Lekë.

Bazuar në amendamentin Nr. 9685 datë 26 shkurt 2007 “Mbi aktivitetin e sigurimit dhe risigurimit dhe mbi ndërmjetësimet e sigurimit dhe risigurimit”, fondi i garancisë së shoqërisë duhet të jetë mbi 370,000,000 Lekë.

Depozitat me afat me institucionet financiare përfshijnë depozitat e mëposhtme në monedhat përkatëse:

	31 Dhjetor 2013	%	31 Dhjetor 2012	%
Euro	188,306,069	1.8-4.0%	191,738,891	3.3-3.8%
USD	41,864,460	2.00%	43,504,350	2.50%
Total	230,170,529		235,243,241	

Depozitat me afat janë të paraqitura në bazë të maturitetit kontraktual si më poshtë:

	31 Dhjet.2013	31 Dhjetor 2012
12 mujore	452,496,428	252,135,067
2 vjecare	31,657,966	238,557,066
Total	484,154,394	490,692,133
Interes I maturuar	-	-
Total	484,154,394	490,692,133

9 Aktive të lidhura me risigurimit

Rezerva e risigrueruesit më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 është llogaritur si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Rezerva e demeve pjesa e risigrueruesit	8,659,032	87,036,463
Rezerva e primit te pafitur pjesa e risigrueruesit	4,818,002	5,537,707
Mjete Motorike	-	-
Prona	4,818,002	5,537,707
	-	-
Total	13,477,034	92,574,170

10 Llogari të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera llogari të arkëtueshme

31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
--------------------	--------------------

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Llogari te arketueshme nga policmbajtesit	111,477,368	174,994,435
Parapagime qiraje	-	(0)
Personeli	17,159,624	23,353,480
Inventari	31,723,895	9,009,576
Te arketueshme nga ortaket	-	3,529,055
Te tjera	6,837,146	30,346,004
Total	167,198,033	241,232,550

11 Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre janë të paraqitura si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Para ne Arke	524,132	417,817
Llogari rrjedhese ne banke	-	-
Ne leke	3,428,341	9,700,592
Ne Valute te huaj	3,059,581	6,648,601
	-	-
Total	7,012,054	16,767,009

12 Kapitali aksionar

Kapitali aksionar i shoqërisë është i paraqitur në Lekë dhe është 100% në pronësi të Z. Dritan Çelaj. Kapitali i nënshkruar i shoqërisë si më 31 dhjetor 2013 është 657,730 mijë Lekë (31 dhjetor 2012: 628,336 mijë Lekë) të përbërë nga aksione të zakonshme me vlerë nominale 10,000 Lekë.

Rezerva të përgjithshme

Më 31 dhjetor 2012 rezervat e përgjithshme konsistojnë në rezerva ligjore. Në përputhje me ligjin numër 9267, më datë 29 korrik 2004 “Mbi aktivitetin e sigurimit, risigurimit dhe ndërmjetësimit në sigurim dhe risigurim” i ndryshuar nga ligji numër 9338, më datë 16 dhjetor 2004 dhe ligjit numër 9685, më datë 26 shkurt 2007 neni numër 93: ‘Shoqëria e sigurimit krijon dhe mban çdo vit financiar rezervat e saj të sigurisë në një nivel jo më pak se 1/3 e fitimit të vitit financiar, nëse ky fitim nuk përdoret për të mbuluar fitimet e mbartura nga vitet paraardhëse’.

13 Rezerva teknike për dëmet

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Provigjonet për dëmet	161,695,388	228,263,108
Primet e pa-fituara	13,477,034	282,180,609
Totali	393,688,545	510,443,717

Rezerva e dëmeve e njohur në pasqyrën individuale të pozicionit financiar të shoqërisë më 31 dhjetor 2013 është ekuivalente me rezervën e aprovuar nga Autoriteti Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me Nenin 101 të Ligjit “Mbi Aktivitetin e Sigurimit, Risigurimit dhe Ndërmjetësimeve në Sigurime dhe Risigurime” Nr. 9267 datë 29 korrik 2004, dhe Neni numër 14, të Ligjit “Mbi

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Mbikëqyrës të Sigurimeve” Nr. 9268, datë 29 korrik 2004.

Vlerësimi i dëmeve të ndodhura por të pa-raportuara (IBNR) është përgjithësisht subjekt i një shkalle më të lartë pasigurie sesa për dëmet të raportuara. Shoqëria vlerëson IBNR-n mbi bazën e metodës së raportit të thjeshtuar

Metoda aktuale ose kombinimi i metodave të përdorura ndryshon nga viti i aksidentit që merret në konsideratë, nga lloji i produkti dhe nga zhvillimet historike të dëmeve. Duke qenë se këto metoda përdorin informacion historik të zhvillimit të dëmeve ato supozojnë se modeli i zhvillimit historik të dëmeve do të ndodhë përsëri në të ardhmen. Ka disa arsye përse kjo gjë nuk është e thënë të ndodhë duke qenë se identifikimi i ngjarjes varet nga modifikimi i metodave. Arsye të tilla përfshijnë:

- Tendencat ekonomike, ligjore, politike dhe sociale (;
- Ndryshime në përbërjen e kontratave të marra në sigurim;
- Lulatje të rastësishme, duke përfshirë ndikimin e humbjeve të mëdha.

Provizionet për IBNR janë fillimisht të vlerësuara në nivel bruto dhe më pas kryhet një llogaritje e veçuar për të vlerësuar masën e mbulimeve të risigurimit.

14 Detyrime për risigurimet

Detyrime për risigurimet e primeve të ceduar janë të detajuara si më poshtë :

	31 dhjetor 2013	31 dhjetor 2012
Mjete Motorike	21,345,097	34,864,822
Totali	21,345,097	34,864,822

15 Llogari të pagueshme për sigurimet dhe llogari të tjera të pagueshme

Llogari të pagueshme për sigurimet dhe llogari të tjera të pagueshme përbëhen si më poshtë:

	31 December 2013	31 December 2012
Detyrime ndaj autoriteteve fiskale	102,500,705	72,028,734
Furnitore	38,752,116	55,754,020
Detyrime te jashtme per karton jeshil	(345)	88,707
Personeli per t'u paguar	8,182,389	6,864,373
Detyrime ndaj agjenteve	1,459,816	1,866,773
Sigurime shoqerore	6,908,217	3,936,030
Te tjera te pagueshme	(6,170,677)	30,592,234
Pagushme ndaj aksionerit	5,075,655	-
Te pagueshme ndaj Byrose Shqiptare te Sig	-	4,005,479
Taksa dhe te tjera gjoba per tu paguar	-	8,373,151
Total	156,707,876	183,509,500

Detyrimet ndaj autoriteteve fiskale paraqesin detyrime për TVSH- tatimin mbi të ardhurat personale dhe taksa të tjera.

Atlantik sh.a.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013***(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)***16 Primet**

Primet e shkruara bazuar në kategoritë e produkteve përbëhen si më poshtë:

Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2013

	Prime Bruto te Shkruara	Ndryshimi ne rezevat per primet e pafituara	Prime te kaluar ne risigurim	rezervat e Risigurimeve	Prime neto
Mjete Motorike	299,320,663	(35,480,132)	13,643,775	-	321,157,019
Pasuria	61,641,228	(14,272,063)	20,517,047	(719,706)	54,676,539
Shendeti	24,268,886	(435,257)	-	-	24,704,143
Total	385,230,776	(50,187,452)	34,160,822	(719,706)	400,537,701

Per periudhen e mbyllur me 31 Dhjetor 2012

	Prime Bruto te Shkruara	Ndryshimi ne rezevat per primet e pafituara	Prime te kaluar ne risigurim	rezervat e Risigurimeve	Prime neto
Mjete Motorike	522,825,635	10,219,058	27,599,905	-	485,006,672
Pasuria	106,440,994	(7,699,000)	11,215,200	(1,523,932)	101,400,862
Shendeti	37,253,501	(890,947)	-	-	38,144,448
Total	666,520,130		38,815,105	(1,523,932)	624,551,981

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

17 Dëme të ndodhura nga sigurimi

Dëmet e ndodhura sipas llojit të produktit përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Mjete motorike	254,020,479	114,871,229
Prona	2,566,454	2,485,749
Shendet	858,249	511,794
Deme te paguara nga risiguruesi	(19,776,509)	(76,054,644)
Totali i demeve te Paguara	237,668,673	41,814,128
Ndryshimi ne rezervat per demet	(66,567,721)	(14,784,492)
Ndryshimi ne rezervat per trajtim demi	-	-
Deme te paguara nga risiguruesit	65,866,531	28,009,878
Deme neto te paguara	236,967,483	55,039,514

18 Shpenzime të tjera operative

Shpenzime të tjera operative përbëhen si më poshtë:

	31 Dhjetor 2013	31 Dhjetor 2012
Shpenzime Personeli	42568449.02	47388625
Shpenzime reklame e sponsorizimi	45647660	16679572.48
Qira	38552742.02	42383471.15
Humbje nga mosarketimi i debitoreve	6978381.01	52256459
Shpenzime administrative	46412419	64477057.49
Fond kompenzimi Byroja Shqiptare e sigurimeve	32534752	26934573
Amortizimi	1962791.2	27836995

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Shpenzime postare dhe telekomunikacioni	3497076.55	5564095.42
Sherbime te jashtme	5450285.8	6173808.5
Shpenzime udhëtimi e transporti	4108475.96	823370.09
Shpenzime mirembajtje e riparimi	2589649.12	7321084.58
Gjoha	0	2094176.48
Taksa lokale	83199.99	3518031.13
	230,385,882	303,451,319

19 Fitimet/(Humbjet) nga këmbimi valutor

	2013	2012
Fitimet nga këmbimi valutor	5,074,890	4,138,575
Humbjet nga këmbimi valutor	-6,138,207	(4,113,958)
Totali	-1,063,317	24,617

Tatimi fitimi në Shqipëri ka një normë 10% (2012:10%) të fitimit të tatueshëm. Më poshtë kemi paraqitur rakordimin e tatim fitimit të llogaritur me normën e aplikueshme të tatim fitimit:

Më poshtë kemi një rakordim të fitimit financiar të llogaritur sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar dhe fitimit të tatueshëm të llogaritur në bazë të ligjeve fiskale në fuqi:

	2012	2013
Fitimi para tatimit	63,809,467	(161,748,260)

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Shpenzime të panjohura	67,527,839	10,090,033
Fitim i tatueshëm	131,337,306	(151,658,228)
Përqindja e taksës	10%	10%
Tatimi mbi fitimin	13,133,731	(15,165,822.79)

22 Menaxhimi i rrezikut të sigurimit

Shoqëria pranon rrezikun e sigurimit nëpërmjet kontratave të saj të sigurimit kur ajo pranon rrezikun e humbjes nga persona ose organizata që janë subjekt direkt i humbjeve të ndodhura. Shoqëria është e ekspozuar ndaj pasigurive si pasojë e kohës, frekuencës dhe pasojave të dëmeve nën këto kontrata.

Shoqëria menaxhon rrezikun e saj nëpërmjet strategjisë së nënshkrimeve dhe risigurimeve me një strukturë të përgjithshme të menaxhimit të rrezikut. Çmimi bazohet në supozimet të cilat kanë parasysh tendencat dhe eksperiencën e mëparshme. Ekspozimet janë menaxhuar duke patur limite dhe kritere të dokumentuara nënshkrimesh. Risigurimi është blerë për të lehtësuar efektin e humbjeve të mundshme të shoqërisë nga ngjarje të mëdha individuale apo katastrofike dhe gjithashtu për të siguruar akses në rreziqe specifike dhe për të asistuar në kapitalin menaxhua. Politikat e risigurimit janë përcaktuar me risiguresit e aprovuar sipas ndarjes proporcionale të tejkalimit të humbjeve dhe sipas marrëveshjeve fakultative.

Kapitali rregullator gjithashtu është menaxhuar (megjithëse jo vetëm) duke ju referuar rrezikut të sigurimit tek i cili është ekspozuar shoqëria.

Shoqëria shkruan rreziqe prone, përgjegjësie dhe motorike paraprakisht me zgjatje kohore mbi 12 muaj. Rreziqet kryesore vijnë si rezultat i fatkeqësive natyrore, ndryshimet klimaterike dhe katastrofa të tjera (p.sh. ngjarje me impakt të lartë dhe me frekuencë të ulët). Një përqendrim i rrezikut mund të vijë gjithashtu nga një kontratë e vetme sigurimi e lëshuar tek një tip demografik i veçantë policë-mbajtësi, së bashku me vendndodhjen gjeografike ose tek tipet e biznesit tregtar. Varieteti relativ i rezultatit lehtësohet nëse ka një portofol të gjerë të rreziqeve të njëjta.

Përqendrimi i rezervave për dëmet sipas tipeve të kontratave më 31 dhjetor 2012 është përmbledhur si më poshtë, referuar detyrimit të sigurimit:

	Bruto	Risiguruesi	2012 Neto
Linja e biznesit			
Mjete motorike	222,244,858	-	222,244,858
Prona	5,072,036	-	5,072,036
Shëndeti dhe aksidentet	946,214	-	946,214
Totali	228,263,108	-	228,263,108

Atlantik sh.a.**Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013**

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

Përqendrimi i rezervave për dëmet sipas tipeve të kontratave më 31 dhjetor 2011 është përmbledhur si më poshtë , referuar detyrimit të sigurimit:

	Bruto	Risiguruesi	2013 Neto
Linja e biznesit			
Mjete motorike	154,485,559	-	154,485,559
Prona	5,657,927	-	5,657,927
Shëndeti dhe aksidentet	551,901	-	551,901
Totali	161,695,388	-	161,695,388

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

23 Menaxhimi i rrezikut financiar

23.1 Rreziku i normës së interesit

Rreziku i normës së interesit përbëhet nga rreziku i luhatjeve të vlerave të instrumenteve financiare si pasojë e ndryshimeve në normat e interesit të tregut dhe rreziku që maturitetet e interesave në lidhje me aktivet të ndryshojë nga maturiteti i interesave të lidhura me detyrimet e përdorura për këto aktive. Kohëzgjatja për të cilën është fiksuar norma e interesit mbi një instrument financiar tregon se ndaj çfarë niveli rreziku të normave të interesit është ekspozuar. Aktivet dhe pasivet e shoqërisë kanë norma interesi të tregut.

Shoqëria nuk ka detyrime që mbartin interes dhe rreziku i shkaktimit të kostove të rëndësishme që vijnë si shkak i rritjes në normat e interesit është rrjedhimisht i parëndësishëm. Në krahun tjetër, aktivet interes mbartëse kanë normë interesi fikse.

23.2 Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut të mospagimit të detyrimeve kontraktuale nga ana e një pale tjetër të cilat do të rezultojnë në humbje financiare të shoqërisë. Në rrjedhën normale të aktivitetit, kur shoqëria arkëton primet, fondet investohen për të paguar detyrimet e ardhshme ndaj policëmbajtësve. Shoqëria është e ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në lidhje me instrumentet e borxhit të mbajtura deri në maturim, depozitat me afat dhe risiguruesit. Shoqëria ka vendosur procedura të brendshme nga ku risiguruesit duhet të kenë klasifikime BB- ose norma më të larta dhe rreziku është i monitoruar nga personeli i risigurimeve. Shoqëria administron ekspozimin e saj ndaj rrezikut të kredisë duke monitoruar ekspozimin e saj ndaj instrumenteve të borxhit dhe depozitave me afat.

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012:

	AAA	AA	A	BBB	Të pa klasifikuara	Total
Aktive Financiare						
Aktive të risigurimit	-	8,074,082	33,873,279	9,511,807	28,604,102	80,063,270
Depozitë me afat me bankat	-	-	-	-	499,204,230	499,204,230
Të arkëtueshme nga aktiviteti i sigurimit dhe të tjera të arkëtueshme	-	-	-	-	183,335,965	183,335,965
Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre	-	-	-	-	16,767,009	16,767,009
Detyrime Financiare						
Detyrime të risigurimit	-	-	-	-	34,864,822	34,864,822
Të pagueshme për aktivitetin e sigurimeve dhe të tjera të pagueshme	-	-	-	-	101,030,843	101,030,843

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

23 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

23.2 Rreziku i kredisë (vazhdim)

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013:

Rating	Lek	% of total	Lek	% of total	Lek	% of total	Lek	% of total
AAA	-	0%	-	0%	-	0%	-	0%
AA	-	0%	5,752,317	5%	416,934	1%	-	0%
A+	2,017,232	4%	-	0%	3,501,656	11%	1,750,828	12%
A	2,964,226	7%	-	0%	4,746,812	15%	-	0%
A-	20,179,975	47%	68,268,650	56%	16,192,339	50%	4,602,349	31%
BBB	7,559,727	18%	-	0%	5,680,632	17%	700,331	5%
BB	10,441,216	24%	19,900,660	16%	1,540,734	5%	-	0%
B++	-	0%	-	0%	-	0%	-	0%
B	-	0%	-	0%	-	0%	-	0%
Unrated	-4,402	0%	28,186,354	23%	270,614	1%	7,666,487	52%
Total	43,157,974	100%	122,107,981	100%	32,349,721	100%	14,719,995	100%

23 Menaxhimi i rrezikut financiar (vazhdim)

23.3 Rreziku i risigurimit

Shoqëria cedon rrezik sigurimi për të limituar ekspozimin ndaj humbjeve të nënshkruara nën marrëveshje të ndryshme që mbulojnë linja biznesi të përcaktuara, mbi bashkësigurimin, çdo vit me terma të rinovueshëm dhe mbi baza të tejkalim të humbjes. Këto marrëveshje risigurimi shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Sipas termave të marrëveshjes së risigurimit, risiguroesi bie dakord të rimbursojë shumën e ceduar në rastin kur dëmi është paguar. Gjithsesi shoqëria mbetet përgjegjëse ndaj policë-mbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse ndonjë risiguroes dështon të plotësojë detyrimet që merr përsipër.

Kur përzgjidhet një risiguroes shoqëria merr në konsideratë sigurinë e tyre relative. Siguria e risiguroesit është vlerësuar nga informacioni i normimit publik.

23.4 Rreziku i menaxhimit të kapitalit

Strategjia e shoqërisë në lidhje me rrezikun e kapitalit mbetet e pandryshuar. Struktura kapitale e shoqërisë konsiston në kapitalin aksionar të shoqërisë që përbëhet nga kapitali themeltar, rezervat dhe fitimet e mbartura. Shoqëria menaxhon kapitalin për të siguruar nivelin e duhur të kapitalit në mënyrë që të jetë e aftë të vazhdojë në vijimësi dhe të përmbushë kërkesat rregullore të kapitalit, ndërkohë që maksimizon kthimin tek aksionaret nëpërmjet optimizimit të gjendjes së detyrimeve dhe kapitalit.

Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 kapitali aksionar i shoqërisë është në përputhje me kërkesat e rregullatorëve për sigurimet, për kapitalin e paguar.

23.5 Rreziqe të tjera

Ndryshimet legjislative në segmentet e biznesit në të cilat operon shoqëria mund të ndikojnë tek fitimet. Aktiviteti i sigurimeve është objekt kontrollësh të hollësishme e në zhvillim në Shqipëri. Qëllimi kryesor i këtyre rregulloreve është mbrojtja e të siguarve. Ndryshime të ligjeve mbi sigurimet mund të ndikojnë mbi aktivitetin e shoqërisë dhe të produkteve të ofruara. Ligjet mbi sigurimet dhe rregulloret e ndryshuara në kohë mund të jenë kufizuese dhe me kosto më të larta

Atlantik sh.a.

Shënimet shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(të gjitha shumat janë të shprehura në lekë, përveç se kur specifikohet ndryshe)

24 Angazhime dhe detyrime të kushtëzuara

Çështje gjyqësore

Në veprimtarinë e zakonshme të biznesit, shoqëria përfshihet në çështje të ndryshme gjyqësore. Sipas opinionit të drejtimit dhe avokatit ligjor nuk ka dëme që kërkojnë regjistrimin e një provigjoni në përputhje me SNRF. Nuk ka detyrime të kushtëzuara të rëndësishme ekzistuese në datën e raportimit .

Detyrime tatimore

Për vitin 2013 dhe 2012 librat dhe llogaritë e shoqërisë për efekt të taksave, nuk janë inspektuar nga autoritetet tatimore. Shoqëria ka ndjekur të gjitha rregullat e tatimeve në përlllogaritjen e detyrimeve tatimore, megjithatë interpretimi i autoritetit tatimor mund të ndryshojë me atë të përdorur nga shoqëria .

25 Vlerësimi me vlerë të drejtë

Drejtimi përdor përlllogaritjen dhe parashikimin e tij më të mirë, lidhur me llojin aktiveve dhe detyrimeve për përcaktimin e vlerës së drejtë të instrumenteve financiare ku nuk ka të dhëna të një tregu aktiv .

Vlerë e mbartur e instrumenteve financiare është konsideruar një përafrim i arsyeshëm i vlerës së drejtë.

26 Ngjarjet pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera të rëndësishme që kanë ndodhur pas datës së këtyre pasqyrave financiare që kërkojnë rregullim apo shënime shpjeguese.